


Tregtia e jashtme e mallrave

Prill 2025

Tiranë, më 19 Maj 2025: Në Prill 2025 eksportet e mallrave arritën vlerën 33 mld lekë, duke u ulur me 4,1 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 5 %, në krahasim me Mars 2025. Importet e mallrave arritën vlerën 76 mld lekë, duke u rritur me 0,4 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 2,5 % në krahasim me Mars 2025. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 43 mld lekë, duke u rritur me 4,3 %, krahasuar me Prill 2024 dhe me 9,3 %, në krahasim me Mars 2025.

Fig.1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë katërmujor, eksportet e mallrave arritën vlerën 133 mld lekë, duke u rritur me 2,3 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 277 mld lekë, duke u ulur me 2,5 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 144 mld lekë, duke u ulur me 6,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Prill 2025, në rënien e eksporteve prej 4,1 % kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6,1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,3 pikë përqindje “Produkte kimike dhe plastike” me -0,8 pikë përqindje etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +3,4 pikë përqindje, “Makinë, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,1 pikë përqindje.

Për publikim 19/05/2025


Vijon

Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Prill 2025

Eksportet, gjatë këtij katërmujori janë rritur me 2,3 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +8,9 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,6 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,5 pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6,1 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” dhe “Tekstile dhe këpucë” me -0,8 pikë përqindje, etj.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Prill 2025, në rritjen e importeve prej 0,4 %, krahasuar me Prill 2024, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Produkte kimike dhe plastike” dhe “Prodhime druri dhe letre” me +0,5 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -0,6 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -0,3 pikë përqindje dhe “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -0,1 pikë përqindje.

Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Prill 2025

Si katërmujor, importet janë ulur me 2,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -3,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,7 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +1,3 pikë përqindje, “Ushqim, pije duhan” me +0,3 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,3 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Prill 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rënien më të madhe të eksporteve, në krahasim me Prill 2024 janë: Italia (7,7 %), Spanja (27,1 %), Kina (32,8 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kosova (87,1 %), Greqia (11,4 %), Gjermania (10,5 %), etj.

Gjatë këtij katërmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (81%), Greqia (9,3 %) dhe Gjermania (6,6 %). Ndërsa vendet me të cilat ka pasur uljen më të madhe janë: Italia (12,5 %) , Maqedonia e Veriut (30,8 %) etj.

Në muajin Prill 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, janë: Kina (11,1 %), Maqedonia e Veriut (18,9 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (3,9 %), Turqi (5,6 %), Greqia (5,9 %), etj.

Gjatë këtij katërmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Itali (1,3 %), Turqia (21,9 %), Gjermania (9,0 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe janë: Kina (23,7 %), Greqia (3,0 %) dhe Spanja (5,7 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Prill 2025



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 54,9 %, të gjithë tregtisë. Në Prill 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 64,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 50,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (25,8 %), Kina (8,9 %), Turqia (7,9 %), Greqia (7,4 %).

Shkëmbimet tregtare, për katërmujorin e parë 2025, me vendet e BE-së zënë 57,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Prill 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 67,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,4 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,2 %), Kina (8,7 %) dhe Greqia (7,8 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Prill 2025

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2024		373	-15,4	894	2,5	-522	41,7
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	08 - 23	27	-21,9	68	-15,0	-40	40,6
	09 - 23	34	-12,8	73	-16,6	-40	45,8
	10 - 23	37	-4,3	78	-6,3	-42	46,8
	11 - 23	33	-21,8	72	-7,4	-39	46,0
	12 - 23	38	-6,6	73	-23,1	-35	51,7
Jan-Dhj 23		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5
	02 - 24	32	-16,1	74	6,4	-42	43,5
	03 - 24	33	-21,0	75	-7,0	-42	44,4
	04 - 24	35	1,8	75	0,6	-41	45,9
	05 - 24	35	-12,4	79	-1,6	-45	43,8
	06 - 24	35	-8,9	77	2,1	-42	45,3
	07 - 24	33	-12,0	85	21,1	-52	39,0
	08 - 24	22	-18,2	69	1,9	-46	32,6
	09 - 24	31	-8,5	71	-3,1	-40	43,3
	10 - 24	31	-15,2	77	-1,5	-46	40,3
	11 - 24	30	-8,5	73	2,0	-43	41,2
	12 - 24	26	-31,7	79	8,3	-53	32,6
Jan-Dhj 24		373	-15,4	894	2,5	-522	41,7
2025	01 - 25	31	4,9	60	0,1	-29	51,8
	02 - 25	34	4,3	68	-8,6	-34	49,7
	03 - 25	35	4,9	74	-1,4	-39	47,3
	04 - 25	33	-4,1	76	0,4	-43	43,8
	Jan-Prill 25	133	2,3	277	-2,5	-144	47,9

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Prill 2025

	Eksporte				Importe			
	Prill 2024	Prill 2025	Jan. - Prill 2024	Jan. - Prill 2025	Prill 2024	Prill 2025	Jan. - Prill 2024	Jan. - Prill 2025
Vendet e BE-së	23.842	21.383	94.866	89.515	40.322	38.404	148.283	145.402
Austri	296	90	913	601	585	628	2.381	2.349
Gjermani	1.666	1.840	7.453	7.945	5.313	4.897	21.215	19.300
Greqi	1.950	2.173	7.851	8.583	6.296	5.922	22.638	23.313
Itali	13.692	12.631	58.890	51.554	16.086	15.467	60.906	60.135
Spanjë	2.061	1.503	4.414	6.298	1.244	1.224	4.208	4.449
Kroaci	303	226	1.716	724	248	582	1.028	1.905
Të tjera të BE-së	3.875	2.919	13.629	13.810	10.551	9.684	35.906	33.952
Mbretëri e Bashkuar	136	111	532	423	1.246	776	3.144	2.707
Kinë	1.526	1.025	3.061	2.993	7.797	8.659	26.365	32.606
Kosovë	3.171	5.933	12.640	22.884	1.012	1.110	3.678	3.812
Maqedonia e Veriut	1.603	868	5.006	3.464	1.037	1.233	3.790	4.040
Rusi	-	-	5	6	516	645	1.131	1.180
SHBA	472	410	1.538	1.407	2.174	1.517	7.723	6.088
Turqi	405	423	1.534	1.759	8.618	8.134	36.749	28.703
Ukrainë	3	0	168	295	259	262	1.487	1.423
Zvicër	262	110	713	366	515	939	2.460	3.228
Të tjera	3.155	2.891	9.727	9.708	11.840	13.985	49.472	48.049
Gjithsej	34.575	33.153	129.791	132.821	75.335	75.663	284.283	277.238

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Prill 2025

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Prill 2024	Prill 2025	Jan. - Prill 2024	Jan.-Prill 2025	Prill 2024	Prill 2025	Jan. - Prill 2024	Jan.-Prill 2025
Gjithsej	34.575	33.153	129.791	132.821	75.335	75.663	284.283	277.238
Ushqime, pije, duhan	5.105	5.001	17.239	18.038	12.735	12.774	47.342	48.263
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	7.545	8.721	25.795	37.301	7.767	7.702	26.871	30.507
Produkte kimike dhe plastike	1.444	1.174	5.160	4.156	10.241	10.637	38.333	39.116
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	214	157	827	675	1.037	1.052	4.140	3.832
Prodhime druri dhe letre	882	807	3.369	3.359	2.532	2.892	9.341	9.183
Tekstile dhe këpucë	9.371	8.934	36.772	35.718	7.575	7.129	27.668	27.486
Materiale ndërtimi dhe metale	6.124	4.013	24.589	16.661	10.073	10.179	40.510	38.457
Makineri, pajisje dhe pj. këmb.	3.012	3.407	12.523	13.116	19.847	19.624	77.799	68.084
Të tjera	878	939	3.515	3.797	3.528	3.675	12.279	12.309

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Prill 2025

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	58.890	51.554	12.640	22.884	7.851	8.583	7.453	7.945
Ushqim, pije duhan	5.115	4.477	1.777	1.881	1.416	1.593	504	524
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	5.048	1.833	2.994	17.335	854	1.097	2.536	2.150
Produkte kimike dhe plastike	2.025	1.446	1.247	947	316	259	11	23
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	688	553	1	11	101	64	1	0
Prodhime druri dhe letre	1.832	1.914	381	351	531	521	37	36
Tekstile dhe këpucë	27.876	26.197	61	31	2.742	3.022	3.055	3.546
Materiale ndërtimi dhe metale	7.709	7.104	5.193	949	1.528	1.554	229	336
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	6.753	6.077	581	993	78	93	940	1.140
Të tjera	1.844	1.952	404	387	286	378	141	188

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Prill 2025

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	60.906	60.135	36.749	28.703	26.365	32.606	22.638	23.313
Ushqim, pije duhan	9.385	10.199	1.876	1.867	638	702	6.241	6.463
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	1.352	2.950	5.571	2.301	6	7	3.272	4.283
Produkte kimike dhe plastike	7.627	7.671	3.880	3.833	2.154	2.715	4.102	4.131
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	3.245	2.980	103	144	301	297	93	51
Prodhime druri dhe letre	1.952	1.942	1.627	1.542	541	637	1.262	1.260
Tekstile dhe këpucë	12.165	11.659	3.609	3.164	4.255	4.512	2.259	2.166
Materiale ndërtimi dhe metale	7.490	7.187	10.039	10.515	3.667	5.512	3.322	2.857
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	14.642	12.465	8.840	3.892	12.395	15.388	1.239	1.445
Të tjera	3.049	3.083	1.203	1.446	2.409	2.835	848	657

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumania, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri